

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **KQZ** me objekt: “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, për periudhën 1/1/2010 deri më datën 31/12/2011” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 86, datë 07/06/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 166/6, datë 07/06/2012 dërguar **Z. Arben Ristani, Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i shpenzimeve operative u konstatua se, shpenzimet për energji elektrike zënë 16,5% të totalit të shpenzimeve. Ky zë shpenzimi si për periudhat e mëparshme ashtu edhe për periudhën objekt auditimi nuk likuidohet sipas përdorimit në fakt të energjisë elektrike, por me një vlerë (kuotë) fikse mujore prej 172,340 lekë (me t.v.sh.) sipas një marrëveshje me Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, pa përcaktuar sasinë mujore kW/orë të harxhuar në fakt, pasi KQZ, furnizimin me energji elektrike e merr nga DSHQ. Kjo mënyrë veprimi krijon kushte favorizuese për pjesën e t.v.sh. së zbritshme që llogarit DSHQ, me Degën e Tatim Taksave.

Për këtë, **rekomandojmë** marrjen e masave për ndërtimin e një linje të re me qëllim shkëputjen e energjisë elektrike dhe lidhjen e pavarur të saj nga DSHQ, me qëllim likuidimin e këtyre shpenzimeve sipas sasisë së shpenzuar në fakt.

Menjëherë në bashkëpunim me DSHQ

2. Nga auditimi i shpenzimeve operative u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, shpenzimet për ruajtjen e objekteve në Lundër, kapin vlerën rreth 6 milionë lekë ose rreth 18,6% të totalit të shpenzimeve operative. Procedurat për këtë zë shpenzimi, janë kryer me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Për kufizimin e këtyre shpenzimeve, **rekomandojmë** bashkëveprimin e KQZ me Ministrinë e Brendshme, për marrjen e masave dhe kryerjen e një procedure prokurimi të përqendruar, pasi magazinat e KQZ, janë brenda territorit të Rezervave të Përgjithshme të Shtetit. Në këtë mënyrë, bashkimi i fondeve të dy institucioneve, do të favorizojë kushtet për një pjesëmarrje më të gjerë të operatorëve ekonomikë, me pasojë rritjen e konkurrencës dhe uljen e shpenzimeve për këtë zë.

Në vazhdimësi në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme

3. Nga auditimi i kryer mbi dokumentimin e veprimeve kontabile për aktivet e qëndrueshme të marra falas u konstatua se, me fletë hyrjen nr. 14, datë 7/9/2010 është marrë në dorëzim me transferim kapital nga Rezervat e Përgjithshme të Shtetit, një depo (magazinë) me sipërfaqe 960 m² me vlerë kontabile 259,352 lekë. Për këtë objekt, nuk është bërë rivlerësimi me çmimet aktuale të tregut, si dhe nuk është bërë kontabilizimi si për vlerën e objektit ashtu edhe për truallin pjesë përbërëse e objektit të transferuar. Gjithashtu, edhe në bilancin kontabël të mbylljes së vitit ushtrimor 2010, ky objekt nuk është pasqyruar në formatin nr. 6 “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” për vlerën fillestare në llogarinë 210, dhe amortizimi i llogaritur për këtë objekt.

Për këtë, **rekomandojmë** bërjen e rivlerësimit të këtij objekti me çmimet e tregut, hipotekimin dhe kontabilizimin e vlerës së re në llogarinë përkatëse “aktive të trupëzuara”.

Menjëherë

4. Nga auditimi i detyrimeve debitore të subjekteve politike u konstatua se, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 87, të “Kodit zgjedhor”, nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve nga subjektet zgjedhore që nuk kanë fituar asnjë mandat në Kuvend, apo nuk kanë kaluar pragun e përcaktuar në “Kodin Zgjedhor”, sipas të cilit në zgjedhjet e radhës duhet të kthejnë shumën përkatëse të përfituar.

Për këtë, **rekomandojmë që**, në zgjedhjet e ardhshme, KQZ në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të marrin masat për arkëtimin apo sistemimin e detyrimeve të krijuara në zgjedhjet e mëparshme, nga 8 subjekte zgjedhore **në vlerën prej 14,349,926 lekë**.

Në vazhdimësi

5. Nga auditimi i kryer në shpenzimet operative për periudhën objekt auditimi, u konstatua se, shpenzimet për telefona celularë për vitin 2010, zënë një peshë specifike të konsiderueshme ndaj totalit të shpenzimeve operative, kështu për vitin 2010 ato përfaqësojnë 8,6% të totalit të shpenzimeve.

Për këtë, **rekomandojmë që**, KQZ në buxhetin e miratuar të vitit 2012, të bëjë ndryshimet përkatëse, për të zbatuar me rigozitet pikën 12, të VKM nr. 864, ku është përcaktuar që, shpenzimet për telefona celularë të mos kalojnë masën 2% të totalit të shpenzimeve operative. Gjithashtu, ky rekomandim të shoqërohet edhe me shfuqizimin e urdhrit të Kryetarit të KQZ nr. 61, datë 20/9/2010 “Për përcaktimin e limiteve mujore të telefonisë celulare për anëtarët e KQZ-së” dhe përcaktimin e limiteve konform dispozitave ligjore në fuqi.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Mbështetur në nenin 27, të ligjit nr. 7961, datë 12/7/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet e mëvonshme, të nxirret urdhri për shpërblim dëmi, të kryen kontabilizimet dhe të behen ndalesat, për 24 punonjës **në vlerën prej 792,000 lekë**, për sa përfituar shpërblime në kundërshtim me pikën 1, germa “b” të VKM nr. 591, datë 23/7/2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore VKM nr. 472, datë 2/7/2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore të vitit 2011”, pika 1, germa “b”.

Menjëherë

2. Të kërkohet në mënyrë ligjore arkëtimi **i vlerës 287,352 lekë**, të përfituara padrejtësisht nga shoqëria ■■■■■, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 8/5/2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 3, datë 30/1/2006 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, pika 7 “Furnizimet e tatueshme dhe ato të përjashtuara”, gërmat “b” dhe “c”.

Menjëherë.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Andrea Kristo, Ludmilla Sulo dhe Vladimir Rizvani. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë zj. Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT